UDHËZIM
Nr.31, datë 13.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR DETAR, AJROR DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT, TË MALLRAVE DHE PASAGJERËVE ME TVSH ZERO

(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 27, datë 27.12.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 31 dhe *19.2* të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për TVSH-në", të ndryshuar, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit

UDHËZOJNË:

1. TVSH-ja aplikohet në masën zero për qind për furnizimin e shërbimeve në lidhje me transportin e mallrave dhe pasagjerëve dhe shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit, si më poshtë:

I. Transporti ndërkombëtar detar

a) Shërbimi për përdorimin e kanalit të portit, nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

b) Shërbimi për qëndrimin në kalatat e portit të mjeteve lundruese që operojnë në transport ndërkombëtar.

c) Shërbimi për qëndrimin në kalata pas veprimeve tregtare të mjeteve lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar.

d) Shërbimi i përdorimit të kalatës nga mjetet lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar.

e) Shërbimet shëndetësore dhe sanitare që kryhen në mjetet lundruese të destinuara për transportin ndërkombëtar.

f) Shërbimi për ngarkimin e mallrave, si dhe shërbimet ndihmëse (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

g) Shërbimi për shkarkimin e mallrave deri në kalata dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

h) Shërbimet për ngarkimin e kontenierëve, si dhe shërbimet ndihmëse (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

i) Shërbimet për shkarkimin e kontenierëve deri në kalata dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

j) Shërbimet për çdo prekje të trageteve që operojnë në transportin ndërkombëtar;

k) Shërbimi për imbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

l) Shërbimi për çimbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

m) Shërbimet e pastrimit, riparimit apo mirëmbajtjes të mjeteve lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

n) Shërbimi për mbrojtjen kundër zjarrit për mjete lundruese dhe ngarkesën e tyre, që operojnë në transportin ndërkombëtar.

o) Shërbimi i furnizimit me pjesë këmbimi, materiale, karburant, vajra dhe me ushqime të mjeteve lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

II. Transporti ndërkombëtar ajror:

a) Shërbimet për uljen e ngritjen e avionëve për transport ndërkombëtar.

b) Shërbimi i ndriçimit të pistës së ulje-ngritjes së avionëve për transport ndërkombëtar.

c) Shërbimi për drejtimin dhe parkimin e avionëve në pistë për transport ndërkombëtar.

d) Shërbimet e pastrimit, ngarkimit dhe shkarkimit të avionit për transport ndërkombëtar të pasagjerëve.

e) Shërbimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e avionëve për transport ndërkombëtar.

f) Shërbimet për përdorimin e pajisjeve të aeroportit të destinuara për avionë për transport ndërkombëtar.

g) Shërbimet që kryhen për sigurinë, ruajtjen dhe kontrollin e pasagjerëve dhe mallrave në aeroporte, të destinuara për transport ndërkombëtar.

h) Shërbimet e avaro-shpëtimit.

i) Shërbimi i furnizimit me materiale në avion, karburante për avionët dhe shërbimi katering në avion.

III. Shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit

a) Shërbimi i interkonjeksionit ndërkombëtar.

b) Shërbimi ndërkombëtar “Roaming”, i kryer nga një operator vendas për operatorë të huaj.

2. Në çdo rast, sipas specifikimeve të mësipërme, tatimpaguesi duhet të vërtetojë me anë të dokumentacionit përkatës se shërbimi i kryer është në funksion të transportit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve.

Ky udhëzim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT **Sokol Olldashi**	MINISTRI I FINANCAVE **Ridvan Bode**	MINISTRI I INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT **Genc Pollo**